



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1046/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Afijete Sada Glllogjani anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e koordinatorit të këshillit të vendvotimit Faton Hajrizi nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1046/2021 i datës 04.11.2021, i ushtruar nga koordinatorit të këshillit të vendvotimit Faton Hajrizi nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajit, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet me nr.2127B/01D, 2110B/01R, 2115B/02R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1046/2021 të paraqitur nga Faton Hajrizi, koordinatorit i këshillit të vendvotimit nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se në qendrat e votimit 2127B/01D, 2110B/01R, 2115B/02R, votat e subjektit të tyre politik i janë shpallur te pa vlefshme dhe nuk i janë numëruar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Faton Hajrizi, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimet 2127B/01D, 2110B/01R, 2115B/02R.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tije, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apellesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të

pranueshme, për faktin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi, formular apo ndonjë deklaratë që do të dëshmonte se pretendimet e tije për pa rregullsi në vendvotimet përkatëse janë te bazuara.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.1046/2021 më datën 06.11.2021



Kryesues i Panelit
Zyhdë Haziri

***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*